



MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

Kolegji i Menaxhmentit Internacional “Globus”- Prishtinë

dhe

Sindikata e Policisë së Kosovës - SPK

Neni 1. Qëllimi i Memorandumiit

1. Përmes këtij Memorandumiit të Mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellë, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

Neni 2. Lënda e Memorandumiit

1. Me anë të këtij Memorandumiit, Kolegji “Globus” merr përsipër ofrimin e bursave për shkollim për punonjësit e organizatës së lartpërmendur dhe familjarët e tyre.
2. Bursat ofrohen për nivelin e studimeve Bachelor për tri vite studimi. Ndërsa për programin Master kandidatët të cilët kane përfunduar studimet Bachelor sistemin tre vjeçar, studimet Master zgjasin dy vite. Pagesa mund të bëhet deri me 12 këste.
3. Skema e çmimeve zyrtare:

Skema për studime Bachelor				
Nr.	Përshkrimi	Çmimi zyrtar (€)	Përqindja e zbritjes (€)	Çmimi pas zbritjes (€)
1.	Policët Aktiv	3v x 1,200 = 3,600	50 %	1,800
2.	Fëmijët e Policëve të rën në detyrë	3v x 1,200 = 3,600	100 %	0
3.	Fëmijët e Policëve të vdekur	3v x 1,200 = 3,600	50 %	1,800
4.	Familjarët e ngusht të Policëve	3v x 1,200 = 3,600	40 %	2,160

Skema për studime Master				
Nr.	Përshkrimi	Çmimi zyrtar (€)	Përqindja e zbritjes (€)	Çmimi pas zbritjes (€)
1.	Policët Aktiv	2v x 1,800 = 3,600	50 %	1,800
2.	Fëmijët e Policëve të rën në detyrë	2v x 1,800 = 3,600	100 %	0
3.	Fëmijët e Policëve të vdekur	2v x 1,800 = 3,600	50 %	1,800
4.	Familjarët e ngusht të Policëve	2v x 1,800 = 3,600	40 %	2,160

Skema të shërbimeve tjera akademike				
Nr.	Përshkrimi	Çmimi zyrtar (€)	Përqindja e zbritjes (€)	Çmimi pas zbritjes (€)
1.	Punime në Konferencë me ISBN	150	100 %	0
2.	Punime në revista me ISSN	150	100 %	0
3.	Trajnime	100	100 %	0

4. Përfituesit e bursave nga ky Memorandumi mundë t'i vazhdojnë studimet në Programet e Licencuara dhe Akredituara nga MASHT dhe AKA.
5. Përmes këtij Memorandumi të Mirëkuptimit **Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK)** do t'i mundësojë studentëve të Kolegjit "Globus" përfundimin e punës praktike me kohëzgjatje të dakorduar në mes të Kolegjit "Globus".
6. Me anë të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, palët dakordohen që të bëjnë shkëmbimin e stafit **(në raste të caktuara)** për pjesëmarrje në ligjërata publike apo evente të organizuara në frymën profesionale.
7. Për aktivitete të planifikuara Kolegji do të ofrojë staf kompetent dhe hapësirë me kushtet të nevojshme.
8. Të shfrytëzojnë dijen e akumuluar dhe eksperiencën e dy palëve, në drejtim të gjetjes së zgjidhjeve shkencore dhe praktike nga lëmi i ekonomisë dhe biznesit, çdoherë kur për këtë shprehet interesimi i dyanshëm;
9. Palët do të shfrytëzojnë mundësitë e bashkëpunimit intensiv gjatë punimit të temave të diplomës Master, si dhe të shtrojnë dhe të zhvillojnë hipotezat për studime doktorate të kandidatëve të tyre;
10. Palët do të shfrytëzojnë mundësitë e këmbimit të literaturës profesionale – shkencore dhe të shfrytëzimit të bibliotekave, të revistave shkencore dhe të publikimeve tjera me karakter shkencor – profesional;
11. Palët do të bashkëpunojnë në ngritjen e renomesë dhe namit të ndërsjelltë të institucioneve të tyre, si dhe të inicojnë forma inovative të bashkëpunimit;
12. Palët do të shqyrtojnë mundësitë e pjesëmarrjes në manifestimet shkencore kudo në botë, nëse kjo shkon në interesin e tyre shkencor dhe organizativë;
13. Palët do të hulumtojnë mundësitë e participimit në projektet kërkimore vendore dhe ndërkombëtare;

Neni 3. Përzgjedhja e Kandidatëve për Bursa

Përzgjedhja e përfituesve të bursave do të bëhet nga **Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK)** duke respektuar kriteret e përgjithshme. Përvoja paraprake dhe mundësia e kandidatëve për t'u ngritur në karrierë duhet të merren parasysh gjatë procesit të përzgjedhjes. Preferohet që përzgjedhja e kandidatëve të mos koncentrohet në një departament apo nivel të menaxhmentit. Preferohet që të ketë diversitet (gjinor, etnik, fetar dhe social) gjatë përzgjedhjes së kandidatëve. Kandidatet e përzgjedhur duhet të posedojnë kontratën e punës valide me **Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK)** ose në rast se është familjar duhet të ketë autorizim tek noteri, si dhe kopjen e kontratës së **Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK)**.

Neni 4. Përzgjedhja e Kandidatëve për Internship/Punë Praktike

1. Përzgjedhja e Kandidatëve për Internship/Punë Praktike do të bëhet nga Kolegji "Globs" duke marrë parasysh nevojat dhe konkurset e **Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK)**.
2. Kolegji "Globus" do të sigurojë që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre profesionale.

Neni 5. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë;
3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit etik dhe moral.
4. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në Memorandum.

Prishtinë, më 13 Gusht 2018

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji "Globus"
Ahmet ARIFI,
Sekretar Gjeneral

Përfaqësuar nga:
Valbona KAMBERI
Kryetar i Sindikatës (SPK)
